

# Gruas Kosovare

## përmbajtja

- 2 Gratë në të Zeza shënojnë përvjetorin e 1325
- 2 RrGGK Edukon Votuesit mbi Gratë Kandidate
- 2 RrGGK Monitoron Premtimet e Fushatës Zgjedhore
- 2 RrGGK merr Pjesë në Seminarin mbi MVG & ICT
- 2 Shtëpia e Sigurt Ngritë Vetëdijesimin mbi Dhunën
- 3 RrGGK Promovon Shëndetin, Lufton Dhunën e Bazuar në Gjini në Kosovës
- 3 RrGGK merr Pjesë në Takimin Rajonal të Ktk
- 3 Qendra MVPT Hap Bibliotekë
- 4 Shoqata "Kalabria" Lufton Trafikimin, Mbështet Bashkëpunimin Rajonal
- 4 Dera e Hapur Organizon Panairin e Punë - dores
- 4 "Vita-Jeta" Ndhimjnë Gratë Pensioniste

## njoftimet

Prezentimi i Përmbledhjes Ekzekutive të Rezolutës të KSKB 1325

**Hoteli Grand, Prishtinë,  
.....Dhjetor 5, 12:00**

**RRJETI I GRUPEVE TË  
GRAVE TË KOSOVËS**



**KOSOVA WOMENS  
NETWORK**

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)

## Le të Vazhdojë të Dëgjohet Zëri Ynë!!!

Të nderuara anëtare të Rrjetit, anëtarë të Bordit, miq dhe përkrahës të RrGGK,

Ju drejtohem me këtë letër duke dashur që fillimisht të ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj gjatë këtij viti.

Viti 2007, edhe një vit tjetër i punës sonë të përbashkët, edhe një vit tjetër i suksesit tonë. Me 19 Nëntor 2001, u publikua Buletini i parë i Rrjetit me ndihmën dhe përkrahjen e organizatës Advocacy Project nga SHBA. Në nëntor të këtij viti u festua ditëlindja e gjashtë të këtij buletini.

"Gratë e Kosovës në Internet... Ngjarje e ditës... Mrekulli e kohës..." kështu fillonte letra në buletinin e para gjashtë viteve... Një mrekulli kjo që filloi para shumë kohe te gratë tona dhe që vazhdon të rritet duke e ditur që informata është fuqi. Në botën e qytetëruar këtë fuqi mund ta marrim përmes shpërndarjes së informatave; informimit të drejtë; urave të bashkëpunimit pa dallim race, feje, kulture, gjinie; gjë kjo që ne edhe këtë vit u munduam, dhe besojmë që arritëm, ta bëjmë me ju.

Kush është gruaja e Kosovës sot? Ajo me guxim u kyq në organizimin e gjithëmbarshtëm të jetës shoqërore politike, kulturore e ekonomike. Edhe pse para shumë kohësh shumë tema dhe profesione në shoqërinë tonë ishin tabu për gratë, fal punës së shumë organizatave, gruaja zu të afirmohej si mjeke, inxhinierë, pedagogë, artiste, shkrintare, piktores, ekonomiste, politikane, etj... Gruaja sot prin në ballë të të gjitha veprimtarive dhe sferave të jetës shoqërore... Gruaja sot ndihmon dhe mbështet shoqen e saj në vetëdijesimin e avansimin e pozitës se saj në shoqëri e familje... Gratë përbëjnë mbi 50% të popullatës së Kosovës. Ato vijnë nga prapavija të ndryshme, nga qytetet, qytezat dhe fshatrat, me të gjitha nivelet e edukimit dhe me prapavija të ndryshme ekonomike. Këto gra shumë kohë më parë formuan Rrjetin, dhe po ky Rrjet shtohet çdo vit e më shumë. Shumica kanë menduar që organizatat e grave takohen për "biseda të rëndomta" mirëpo nga dita në ditë mbledhen për të diskutuar tema qenësore të pozitës së gruas dhe ato vazhdojnë të takohen për të bashkuar forcat në punën e përbashkët.

Duke ju uruar Festat e Fundvitit dhe duke ju falenderuar edhe njëherë për punën që e bëmë së bashku, le të na prijë viti 2008 me moton: "Le të vazhdojë të dëgjohet zëri ynë!!!"

Me respekt,  
Sfafi i RrGGK

## Gratë Kosovare marrin pjesë në Simpoziumin në Vjenë

Një përfaqësues i RrGGK-së, organizatë anëtare e RrGGK-së, si dhe gra eksperte që përfaqësojnë profesione të ndryshme në Kosovë kanë marrë pjesë në një simpozium të quajtur "Formimi i të ardhmes evropiane – Lidhja e grave serbe dhe shqiptare" në Vjenë më 5-6 nëntor, 2007.

Gra nga Serbia dhe Kosova u ndanë në grupe punuese për të diskutuar çështje siç janë "Edukimi – Strategjitë për zhvillimin e një identiteti evropian", "Media – Strategjitë për parandalimin e konflikteve

dhe bashkërendimin duke e ndërruar imazhin e "Tjetrit", dhe "Marrëdhëniet ekonomike dhe sociale – Strategjitë për rritjen e pjesëmarrjes së grave".

Pjesëmarrësit paraqitën rekomandimet e tyre para Ministreshës Federale Austriake për Marrëdhënie Evropiane dhe Ndërkombëtare, Ursula Plassnik, si dhe para vendimmarrësve ndërkombëtar në fund të konferencës. Në fund të simpoziumit, pjesëmarrësit rikonfirmuan përkushtimin e tyre ndaj prosperitetit, stabilitetit dhe sigurisë brenda një Evrope të bashkuar.

**RrGGK  
Shpërndanë  
Përmbledhjen  
Ekzekutive të Raportit  
1325 të UNSCR-së**

Në përvjetorin e miratimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, RrGGK e ka qarkulluar gjerësisht nëpërmjet internetit përmbledhjen ekzekutive të raportit të tij monitorues në shkallën mbi të cilën është zbatuar Rezoluta në Kosovë.

Përmbledhja është e disponueshme në [www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org).

Raporti i plotë do të lëshohet më 5 dhjetor në Hotel Grand në Prishtinë në orën 12:00.

## Gratë në të Zeza shënojnë përvjetorin e UNSCR 1325

Në përvjetorin e shtatë të miratimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (UNSCR) mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Gratë në të Zeza – Beograd më 31 nëntor organizuan një konferencë në "Qendrën Sava" në Beograd. Në vitin 2005, në përvjetorin e pestë të UNSCR 1325, Gratë në të Zeza – Beograd paraqitën para Kuvendit të Serbisë një rezolutë të quajtur "Gratë, Paqja dhe Siguria".

Kuvendi nuk u përgjigj, andaj kërkesa e tyre u përsërit në vitin 2006. Kuvendi ende nuk ka dhënë përgjigje. Respektimi i standardeve ndërkombëtare dhe konventave është një mënyrë përmes së cilës Serbia mund ta përfshijë vetën aktivisht në komunitetin ndërkombëtar, por refuzimi për të miratuar në dokument të rëndësishëm siç është UNSCR 1325 tregon se Serbia ende nuk është gatshme ta nisë rrugën drejt demokracizimit, bashkërendimit dhe krijimit të një paqeje të qëndrueshme, theksojnë Gratë në të Zeza – Beograd.

Gjithashtu, për të shënuar përvjetorin e UNSCR 1325, Gratë në të Zeza – Beograd, organizuan një performansë të quajtur "Ne jemi të sigurta kur mund të zgjedhim" në Andriæev Venac. Ato gjithashtu bënë kërkesa edhe tek Kuvendi i Serbisë.

## RrGGK Edukon Votuesit mbi Gratë Kandidate dhe mbi Sistemin e ri Elektorale

Në muajin nëntor, RrGGK ka bashkëpunuar me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe me UNIFEM-in për t'i edukuar votuesit mbi sistemin e ri zgjedhor në Kosovë si dhe mbi gratë candidate që garojnë për poste. Organizatat anëtare të RrGGK-së kanë organizuar takime ku kanë marrë pjesë mbi një mijë qytetarë që përfaqësojnë të gjitha grupet et-

nike përgjatë Kosovës.

Gjatë takimeve, anëtarët e RrGGK-së kanë ofruar informata për përdorimin e ri të sistemit elektorale me lista të hapura, si edhe kanë shpërndarë një publikim me informata mbi gratë candidate, publikim ky i përgatitur nga Qendra për Trajnim dhe Studime Gjinore. Përfaqësuesit e RrGGK-së janë shfaqur edhe nëpër debate të mediave lokale për të sqaruar sistemin elektorale.

Gjatë zgjedhjeve, RrGGK ka bashkëpunuar edhe me Komitetin Drejtues të Grave dhe me Anëtarët e Parlamentit për të diskutuar se si gratë në shoqërinë civile mund t'i mbështesin gratë në politikë për t'i gjetur votuesit gjatë fushatave të tyre parazgjedhore. Për këtë dhe për aspekte tjera të bashkëpunimit me gratë në politikë, RrGGK ka marrë mbështetje nga UNIFEM.

## RrGGK Monitoron Premtimet e Fushatës Zgjedhore

Që nga viti 1999, liderët politikë kosovarë kanë përdorur statusin final të Kosovës si arsyetim për dështimin e përbushjes së nevojave të përditshme të qytetarëve të Kosovës. Po sa të vendoset mbi statusin politik final të Kosovës, një sërë problemesh sociale të shoqërisë kosovare do të dalin në pah (p.sh., papunësia e lartë, rrugë të këqija, energjia e parregullt elektrike dhe uji). Politikanët nuk do të mundën më të fshihen pas administratës së Kombeve të Bashkuara për

dështimet e tyre për mospërbushjen e nevojave të qytetarëve që jetojnë në Kosovë. Në të njëjtën kohë, zgjedhjet e nëntorit përdorën një sistem elektorale me lista të hapura, përmes së cilave qytetarët zgjedhën individë në vend të partive politike. Ky sistem i ri elektorale u ka mundësuar qytetarëve edhe t'i mbajnë përgjegjës vendimmarrësit. Tani qytetarët kanë fuqinë që të monitorojnë se si zyrtarët e zgjedhur individualisht, si edhe partitë politike, po i përbushin nevojat e tyre dhe po i aplikojnë premtimet e tyre të bëra gjatë fushatës zg-

jedhore.

Në muajin tetor dhe nëntor të vitit 2007, me mbështetjen e "Balkan Trust for Democracy", RrGGK filloi monitorimin e premtimeve të politikanëve dhe partive politike të bëra ndaj qytetarëve përmes mediave gjatë fushatave të tyre parazgjedhore, si edhe ka mbledhur platformat e partive politike. Në të ardhmen, RrGGK-ja do t'i përdorë këto për tu ndihmuar qytetarëve t'i mbajnë përgjegjës zyrtarët e zgjedhur për premtimet e tyre.

## RrGGK merr Pjesë në Seminarin mbi MVG & ICT

Më 19-21 tetor, dy përfaqësues të RrGGK-së kanë marrë pjesë në një seminar rajonal, Metodologjia e Vlerësimit Gjinnor (MVG) në Sarajevë i organizuar nga "One World Platform for Southeast Europe" (OWPSEE) në mbështetje të "Association for Progressive Communications" (APC) dhe "ZaMirNet". Seminari kishte për qëllim të diskutoheshin temat e ndërlidhura me të drejtat e grave me një përqendrim special për integrimin e gjinisë në

Teknologjinë Informative dhe Komunikuese (ICT). Konferenca rezultoi në një rrjet të ri online rajonal, përmes së cilës pjesëmarrësit planifikuan të ndajnë informata rregullisht.



Pjesëmarrësit nga regjioni, gjatë seminarit të MVG-së dhe TKI-së, të mbajtur më 19-21 tetor, në Sarajevë.

## Shtëpia e Sigurt në Gjakovë Ngrit Vetëdijesimin mbi Dhunën ndaj Grave

Më 30 nëntor, Shtëpia e Sigurt, "Gjakova", planifikon të mbajë një manifestim për të përshëndetur 16 ditët ndërkombëtare të aktivizmit

kundër dhunës ndaj grave. Manifestimi që do të mbahet në restorantin "Veranda" do të përfshijë një seancë informatash, ese dhe vizatime ku rinia reflek-

ton në problemin e dhunës kundër gruas. Fushata ka marrë mbështetje financiare nga UNFPA përmes RrGGK-së.

## RrGGK Promovon Shëndetin, Lufton Dhunën e Bazuar në Gjini në Kosovës

Që nga qershori i vitit 2007, RrGGK ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në një projekt të mbështetur nga "United Nations Population Fund" (UNFPA) i quajtur "Ofrimi i sigurisë, Promovimi i shëndetësisë; Luftimi i dhunës së bazuar në gjini në Kosovë (Providing Security, Promoting Health; Combating Gender-Based Violence in Kosovo). Ky projekt ka për qëllim të ofrojë mbështetje tek gratë dhe fëmijët që vuajnë nga dhuna e bazuar në gjini përgjatë Kosovës si dhe të përmirësojë qasjen për kujdes shëndetësor reproduktiv.

Ndonëse është bërë progres i madh që nga përfundimi i luftës, Kosova ende ka mungesë të infrastrukturës së nevojshme për t'i mbështetur gratë dhe fëmijët që vuajnë nga dhuna e bazuar në gjini. Që nga viti 2000, RrGGK ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive për t'ju qasur këtij problemi, por dhuna e bazuar në gjini mbetet çështje serioze.

Strehimoreve ekzistuese që mbrojnë viktimat nga dhuna u mungon mbështetja e mjaftueshme financiare për të ofruar kujdes adekuat shëndetësor ndaj viktimave, për t'i mbrojtur ata si dhe të asistojnë me riintegrimin e tyre në shoqëri. Veç kësaj, ka pasur edhe mungesë të koordinimit të mjaftueshëm në mesin e të gjithë aktorëve që merren me dhunën e bazuar në gjini. RrGGK ka nisur këtë projekt në bashkëpunim të afërt me organizata anëtare të RrGGK-së për të përmbushur nevojën aq të madhe për themelimin e sistemeve specifike të bashkëpunimit mes shtëpive të sigurta dhe aktorëve tjerë kyç, të asistojnë dhe të mbrojnë viktimat e dhunës.

Përgjatë këtij projekti gjashtëmujorësh, i mbështetur nga



*Përfaqësueset e strehimoreve dhe ekipi hulumtues gjatë trajnimit lidhur me intervistimin e klienteve, të mbajtur më 10 tetor, në zyrën e RrGGK-së në Prishtinë.*

UNFPA, RrGGK-ja ka ofruar mbështetje direkte për katër strehimore në Kosovë. Kjo mbështetje u ka mundësuar strehimoreve të mbulojnë disa nga kostot e tyre themelore operacionale të cilat nuk kanë qenë të financuara nga donatorë tjerë apo nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si edhe për të ofruar qasje të përmirësuar në kujdesin shëndetësor për gratë që ato strehojnë. Strehimoret gjithashtu janë takuar rregullisht për të krijuar procedura të standardizuara përgjatë Kosovës për t'ju asistuar viktimave të dhunës dhe për të mirëmbajtur të dhëna për monitorim të të gjithë Kosovës.

Veç strehimoreve, edhe "Medica Kosova" ka marrë mbështetje direkte, të cilën e ka përdorë për të ofruar shërbime shëndetësore ndaj grave në zona rurale, si edhe ekzaminime për zbulim të hershëm të kancerit në gji, problem shumë serioz që prekë gratë në Kosovë. Në të njëjtën kohë, në bashkëpunim me këto organizata partnere, RrGGK është duke kryer studim kërkimor mbi dhunën e bazuar në gjini në Kosovë dhe marrëdhënien e mundshme të saj me shëndetin riprodhues të grave.

Studimi, i pari i këtij lloji në Kosovë, synon të ofrojë informatat më të freskëta të disponueshme për këtë çështje, si dhe të parashtrijë rekomandime policore të cilat do të përdoren në fushatën media/përkrahje të RrGGK-së, i zbatuar në bashkëpunim të ngushtë me organizata anëtare të rrjetit. RrGGK rekomandimet e studimit do t'i përdorë edhe për të përkrahur institucione relevante për mbështetje të rregullt për strehimoret dhe ndryshimet e linjave të veprimit që kanë të bëjnë me problemet e identifikuar gjatë studimit të RrGGK-së. Fushata mediale ka për qëllim ta rritë vetëdijësimin mbi problemin e dhunës ndaj grave, ndikimin e tij në shëndetin riprodhues dhe për të bërë rekomandime publike të identifikuar gjatë studimit të lartpërmendur ndaj të gjithë aktorëve relevant që punojnë në luftimin e dhunës me bazë gjinore. Gjatë këtyre aktiviteteve, RrGGK-ja dhe organizatat e saja anëtare po mundohen të arrijnë tek gra dhe burra në zona rurale dhe urbane. Prandaj, fushata mediale ka përfshirë si media lokale, ashtu edhe ato nacionale.

grupeve punuese, gratë nga Kosova dhe Shqipëria diskutuan faktorë të zakonshëm që ndikojnë në këto çështje dhe rreth asaj se si mund të bashkëpunojnë rregullisht. Ato gjithashtu diskutuan edhe fushata rajonale në të ardhmen.

### Qendra për Mbrojtjen e Viktimave, Parandalimin e Trafikimit hap Bibliotekë

Në muajin nëntor, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe për Parandalimin e Trafikimit të Qenieve njerëzore (PVPT) hap një bibliotekë. Misioni i bibliotekës në PVPT është ofrimi i resurseve të rëndësishme të ndërlidhura me fushën e kundër-trafikimit njerëzor; barazisë gjinore dhe autorizimit zë grave; psikologji dhe këshillime; menaxhim organizativ; drejtësi dhe të drejtat njerëzore; edukim dhe fusha tjera.

Tani biblioteka përmban 245 tituj, në mesin e tyre 66 libra, 51 udhëzues dhe manualë, 106 raporte dhe 22 ligje, plane, programe dhe deklarata nga e gjithë bota. Biblioteka është e hapur për të gjitha organizatat dhe individët që merren me kundër-trafikimin njerëzor, me dhunën shtëpiake, barazinë gjinore, autorizimin e grave dhe fusha tjera të ndërlidhura.

Nëse dikush dëshiron ta përdorë materialin që gjendet në bibliotekën e PVPT-së, individët duhet të regjistrohen si anëtarë të bibliotekës. Biblioteka e PVPT-së është hapur nga e hëna në të premten nga ora 9:00 – 17:00. Gjatë vikendeve dhe festave zyrtare do të jetë e mbyllur.

Për informata tjera ju lutemi ta vizitoni:  
[www.trafikimi.net](http://www.trafikimi.net)

## RrGGK merr pjesë në Takimin Rajonal të KTK-së

Më 2-4 nëntor, fondacioni "Kvinna till Kvinna Foundation" (KTK) mbajti një takim rajonal në Shqipëri. Meqë KTK bashkëpunon me organizata lokale të grave që vetë-nxjerrin projekte në bazë të nevojave të shoqërisë, ata mblodhën organizatat e tyre partnere nga

Kosova dhe Shqipëria për të diskutuar bregat e grave rreth asaj se si KTK mund të kontribuojë në rajon për t'ju adresuar këtyre çështjeve. Pjesëmarrësit u ndanë në dy grupe punuese: gratë në vendimmarrje dhe në dhunën kundër grave. Gjatë punës së

## Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

038 245 850

Hajdar Dushi C-2, II/8

Prishtinë, Kosovë

### Stafi i RrGGK

#### Igballe Rogova

Drejtoreshë Ekzekutive  
igorogova@yahoo.com

#### Nexhmije Fetahu

Menaxhere e Programit  
cuca\_fetahu@yahoo.com

#### Besa Shehu

Menaxhere e Financave  
besa\_shehu@yahoo.com

#### Alba Loxha

Marrëdhëniet me Publikun  
albaloxha@yahoo.com

### Bordi i RrGGK

Naxhije Buçinca

Delina Fico

Besim M. Kajtazi

Marte Prenkpalaj

Vjosa Dobruna

Belgjyza Muharremi

Behar Selimi

*Zëri i Gruas Kosovare"  
është shkruar dhe dizajnuar nga  
Alba Loxha  
me ndihmën e  
Nicole Farnsworth.*

www.womensnetwork.org

## Shoqata "Kalabria" Lufton Trafikimin, Mbështet Bashkëpunimin Rajonal

Këtë vit, Shoqata e Grave "Kalabria" ka qenë e zënë. Në muajin korrik, shoqata ka nisur një fushatë kundër trafikimit njerëzor në bashkëpunim të ngushtë me qendrën e Grave "Dera e Hapur" (Open Door). Me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Zyrën për Qeverisje të Mirë, Zyrën e Kryeministrit si dhe me qeverinë finlandeze,

ato ngritën vetëdijen mbi trafikimin në rajonin e Prishtinës. Në një projekt tjetër të rëndësishëm të quajtur "Gratë e Kosovës të bashkuara kundër Trafikimit Njerëzor" (Women of Kosovo Joined against Human Trafficking), "Kalabria" ka bashkëpunuar me "Ruka – Ruci" për të ngritur vetëdijesimin mbi trafikimin. Me mbështetjen e dhënë nga IOM-i, ata për-

dorën një performansë për të shpërndarë informata mbi trafikimin përgjatë rajonit të Prishtinës.

"Kalabria" është gjithashtu anëtare e Koalicioneve të Grave për Paqe. Si e tillë, në muajin shtator, përfaqësues nga shoqata morën pjesë në takimet me Gratë në të Zeza – Beograd që u mbajt në Kruševac dhe Novi Pazar.

## "Dera e Hapur" Organizon Panairin e Punimeve të Dorës

Më 28–30 shtator në qendrën e të Rinjve dhe Sportit në Prishtinë, Qendra e Grave "Dera e Hapur" ka organizuar panairin e artizanateve kosovare të quajtur: "Dyert e Hapura – Artizanatet e Kosovës 2007", ku zejtarë, gra dhe burra të etnive të ndryshme nga rajone të ndryshme të Kosovës, shfaqën pjesë të ndryshme të punës që demonstrojnë trashëgiminë kulturore të Kosovës. Artizanatet ishin të punuara dhe përfshinin, dru, gurë, metal, lëkurë, qëndisje, piktura, qeramikë, artikuj argjendarie, skulptura, instrumente muzikore, monedha bakri, lule dhe ushqime tradicionale. Panairi kishte për qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në Kosovës, integrimin me kulturën tjera në Evropë, rigjallërimin e vlerave kulturore dhe stimulimin e tregtisë lokale. Tutje, organizatorët shpresuan ta mbështesin tregtinë dhe të eksportojnë artizanate si burime afatgjata të



*Disa punë dore që ishin ekspozuar gjatë Panairit të Artizanateve të quajtur "Dyert e Hapura – Artizanatet e Kosovës 2007" që u organizua nga OJQ Dera e Hapur më 28-30 shtator në Prishtinë.*

punësimit për zejtarë dhe për ngritjen ekonomike.

Aktiviteti ishte pjesë e "Ditët e Trashëgimisë Evropiane 2007" e mbajtur nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe

Sportit në Kosovës në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe partnerët e tij plotësues: "Trashëgimia Kulturore Pa Kufij", "Intersos" dhe "Dera e Hapur".

## "Vita-Jeta" Ndhmon Gratë Pensioniste

Në tre muajt e fundit, Shoqata e Grave Pensioniste "Vita-Jeta" në Prishtinë ka punuar në një projekt të quajtur "Jeta gjatë periudhës së tretë".

Si pjesë e projektit, ato nënshkruan një marrëveshje me Qendrën Mjekësore Rehabilituese "MIGUN BALLKAN" në Prishtinë, e cila është pajtuar të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit të anëtarëve të shoqatës, duke ofruar terapi

fizike pa pagesë. Shoqata gjithashtu ka bërë marrëveshje edhe me laboratorin "BioCHEM" në Prishtinë, duke iu mundësuar anëtarëve të shoqatës t'ju nënshtrohen analizave me çmime të përgjysmuara. "BioCHEM" është pajtuar të ofrojë kryerjen e analizave të diabetit pa pagesë për anëtarët e shoqatës. Në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare "Nënë

Tereza", "Vita-Jeta" ka siguruar 100 palë syze bifokale për anëtarët e shoqatës, dhe në bashkëpunim me OJQ-në "Kosova Charity", "Vita-Jeta" ka siguruar 24 palë këpucë tenisi për anëtarët.

Projekti ka marrë mbështetje financiare nga UNHCR, "Pro-Credit Bank", Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, etj..